



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të nenit 63 dhe 64 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2020 për identifikimin, konfirmimin dhe votimin e personave të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19, të cilët janë në karantinë shtëpiake dhe votuesit të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datën 17.11.2020, merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e afatit të identifikimit dhe konfirmimit për votuesit të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19, të cilët janë në karantinë shtëpiake dhe votuesit të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit,

- I. Miratohet afatit i identifikimit dhe konfirmimit për votuesit të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19, të cilët janë në karantinë shtëpiake dhe votuesit të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës dhe Mitrovicën e Veriut, që do të mbahen më 29 nëntor 2020.
- II. Afati për identifikimin dhe konfirmimin e votuesve të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19, të cilët janë në karantinë shtëpiake dhe votuesit të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit, fillon nga data 15 nëntor 2020 deri më 26 nëntor 2020.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Prishtinë, 17.11.2020

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

per **Valdete Daka**





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Datë	16.11.2020	Referencë/e	
Për	Komisionin Qendror të Zgjedhjeve		
Nga	Këshillit për Operacione Zgjedhore		
Kopje	Arkivës së KQZ-së		
Lënda	Rekomandim: për Afatin e identifikimit dhe konfirmimit për votuesit të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19 të cilët janë në karantinë shtëpiake dhe votuesit të cilëve iu është caktuar masa e vetë izolimit		

Bazuar në vendimin Nr. 1092 – 2020, i datës 11.11.2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka miratuar vendimin për miratimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 01/ 2020 për Identifikimit, Konfirmimin dhe Votimin e Personave të cilët për shkak të testit pozitiv me COVID-19 janë në karantinë shtëpiake dhe personave të cilëve u është caktuar masa e vetë izolimit.

Lidhur me këtë, Sekretariati i KQZ-së rekomandon që periudha për identifikimin dhe konfirmimin e kësaj kategorie të votuesve të zhvillohet nga data **15.11.2020** deri me datën **26.11.2020**. Data 26.11.2020, do të jetë data e fundit kur KQZ do të pranoj të dhënat nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës me të dhënat e personave që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 për Komunat Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut, ndërsa KKZ-ja do të pranojë të dhënat nga Shtabi Emergjent Komunal i Komunave Podujevë dhe Mitrovicë të Veriut, për votuesit të cilëve u është caktuar masa e izolimit.

Të dhënat e pranuar do të verifikohen në listën e votuesve për këto dy komuna, në mënyrë që një ditë para ditës së zgjedhjeve, KKZ-të të bëjnë vulosjen e emrave të tyre me vulën e VPNV-së, në listat përfundimtare të votuesve.